

20240641458

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT SIPAS MARRËVESHJES SË HUASË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË GAZIFIKIMIT RAJONAL, QË DO TË NËNSHKRUHET NDËRMJET SHOQËRISË AKSIONARE TË KRYERJES SË VEPRIMTARISË ENERGJETIKE – PËRÇIMI I GAZIT NATYROR NOMAGAS SHKUP, NË PRONËSI TË SHTETIT DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshje së huasë për financimin e Projektit të gazifikimit rajonal, që do të nënshkruhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për Kryerjen e Veprimtarisë Energjetike – Përçimi i Gazit Natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi të shtetit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 98.600.000 eurove, nëse Shoqëria Aksionare për Kryerjen e Veprimtarisë Energjetike – Përçimi i Gazit Natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi të shtetit, nuk i përmbush dhe servison detyrimet e Marrëveshjes së huasë.

Neni 2

Me Marrëveshjen e huasë, përcaktohen kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 e këtij ligji, që do të nënshkruhet ndërmjet Shoqërisë Aksionare për Kryerjen e Veprimtarisë Energjetike të Përçimit të Gazit Natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi të shtetit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e Projektit të gazifikimit rajonal.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që rezultojnë nga marrëveshja e huasë nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huasë do t'i kryejë Shoqëria Aksionare e Kryerjes së Veprimtarisë Energjetike – Përçimi i Gazit Natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi të shtetit, nga të ardhurat që i realizon, në afatet dhe kushtet e përcaktuara me Marrëveshjen e huasë nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji ofrohet në dy këste. Kësti i parë është në vlerë prej 66.344.000 eurove, ndërsa kësti i dytë është në vlerë prej 32.256.000 eurove.

Norma e interesit është variabile dhe përbëhet nga EURIBORI gjashtëmujor, i rritur për marginën prej 1%.

Afati i shlyerjes së dy kësteve të huasë nga paragrafi (1) të këtij neni është 15 vjet, me periudhë të përfshirë grejs prej tri viteve. Të dy këstet e huasë do të shlyhen në 24 këste gjysmëvjetore, më datë 10 qershor dhe 10 dhjetor të çdo viti. Afati për shlyerjen e këstit të parë fillon nga data e parë e përfundimit të vitit të tretë nga nënshkrimi i marrëveshjes së huasë, ndërsa afati për shlyerjen e këstit të dytë fillon nga data e parë e përfundimit të vitit të tretë nga dita e disponueshmërisë së shfrytëzimit të transhesë së dytë.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në emër të huamarrësit, do t'i tërheqë mjetet e huasë me provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së këstit të parë në afat prej shtatë ditëve nga dita e efektivitetit të transhesë.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim do t'i tërheqë mjetet të huasë me provizion të njëhershëm në vlerë prej 1% të vlerës së kështit të dytë në afat prej shtatë ditëve nga dita e disponueshmërisë për shfrytëzimin e kështit të dytë.

Shoqëria Aksionare për Kryerjen e Veprimtarisë Energjetike – Përçimi i Gazit Natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi të shtetit, do t'i paguajë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0.5% të huasë në nivel vjetor.

Provizioni për mjetet e patërhequra për transhenë e parë do të fillojë që të përllogaritet pas 60 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së huasë nga neni 1 i këtij ligji.

Provizioni për mjetet e patërhequra për transhenë e dytë do të fillojë të përllogaritet pas 60 ditëve nga dita e disponueshmërisë së shfrytëzimit të kështit të dytë.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella, si rezultat i Marrëveshjes së huasë nga neni 1 i këtij ligji, si dhe Marrëveshjes së garancisë, Ministria e Financave dhe Shoqëria Aksionare e Kryerjes së Veprimtarisë Energjetike – Përçimi i Gazit Natyror NOMAGAS Shkup, në pronësi të shtetit, do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.